

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deonikarsko Društvo

Nr. 511 Data 19.01.2026
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të nenit 8 dhe nenit 10, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Ligjit të Punës, nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., nenit 22 paragrafi 3 dhe 4 i Statutit të Trepça Sh.A., Trepça Sh.A., me datë 19.01.2026 publikon këtë:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës:	Byfe dhe Mirëmbajtje
Koeficienti/Paga:	475€ bruto
Nr. i kërkuar:	1
Kohëzgjatja e emërimit:	Në kohë të pacaktuar, periudha provuese 6 muaj
Data e njoftimit:	19.01.2026
Afati për aplikim:	20.01.2026 – 03.02.2026
Institucioni:	Ndërmarrja "Trepça Sh.A."
Njësia Biznesore:	Menaxhment
Vendi i punës:	Menaxhmenti i Trepça Sh.A.- PIM

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Kujdeset për pastrimin e rregullt të pjesëve të caktuara të objektit të QMP-së;
- Kujdeset për pastërtinë në përgjithësi;
- Kujdeset për shërbimin e kafe/çaj për menaxhmentin;
- Kryen edhe punë të tjera, që i përgjigjen përgatitjes profesionale dhe aftësive të fituara në punë, të kërkuara nga eprori, të cilat nga natyra i përkasin këtij vendi të punës.

2. Kriteret e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me ligj.

3. Kriteret e veçanta

- Diploma e shkollës së mesme;
- Duhet të ketë së paku 3 vite përvojë pune profesionale.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Dëshminë e përvojës së punës profesionale;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për

vepër penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;

- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave të noterizuara mbi kualifikimin arsimor dhe / ose nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- a. Testimi me shkrim- 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” në linkun <https://trepcasha.com/> , tek kategoria Shpallje.

7. Mënyra e aplikimit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokolit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.- Parku Industrial Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00.

8. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

